



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

**ADGJTHP.nr.3/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, U.D. Kryetari i Gjykatës Artan Sejrani, me bashkëpunëtorin profesional Arlind Sharani, në çështjen e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit A.B., sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga S.E., nga fshati ....., Komuna e Prizrenit, me datë 28.03.2022 mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pa bazuar** ankesa e parashtruar nga S.E., nga fshati ....., Komuna e Prizrenit, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.B., e parashtruar në këtë Gjykatë me datë 13.03.2022.

## **A r s y e t i m**

Me datë 13.03.2022, parashtruesja e kërkesës pranë kësaj Gjykate ka parashtruar ankesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të lartcekur. Në vazhdim në ankesë, parashtruesja në mes tjerash ka theksuar se pasi që është kthyer lënda nga Gjykata e Apelit për rivendosje, që nga data 31.08.2021, kur është mbajtur seanca e fundit, gjyqtari nuk ka pranuar ta takojë edhe përkundër faktit se ka qenë disa herë në Gjykatë. Kjo lëndë ka shkaktuar lodhje nga pritjet e tepërta dhe zvarritja e procedurave si dhe lodhje psikike që po i shkaktohet nga vonesat e kësaj lënde dhe se në këtë rast nuk po kërkon asgjë më shume se të caktohet dhe të përfundohet procedura. Në vazhdim shton se në këtë çështje gjyqtari ka konflikt interesi, sepse nuk po vendos në lidhje me këtë çështje dhe se ka vendosur që ti ndaj fëmijët e saj, andaj propozon që pas shqyrtimit të ankesës e konform dispozitave ligjore ndaj gjyqtarit të merret vendim meritor.

Gjyqtari A.B., lidhur me ankesën e parashtruesit, në deklaratën e tij ka theksuar se pas rigjykimit lënda ka marrë numrin e ri dhe atë C.nr. ...., të cilën në zyre e ka pranuar me datë 09.07.2021. Menjëherë pas pranimit ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe atë për datën

31.08.2021. Shqyrtimin kryesor të datës 31.08.2021, ka filluar me administrimin e provave, por pas kërkesës së palëve dhe rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, për dëgjimin e fëmijëve të mitur, nga ta ka kërkuar që të bashkëpunojnë me Qendrën për Punë Sociale në ....., që edhe ata të dëgjojnë fëmijën tjetër të mitur. Kërkesën për dëgjimin të fëmijëve Qendra për Punë Sociale e ka pranuar me datë 07.09.2021, dhe deri më tani nuk i ka dorëzuar raportin. Nga bisedat që ka zhvilluar dy herë me punëtoren e kësaj qendre, është njoftuar se përkundër disa tentimeve dhe thirrjeve që i kanë bërë palës së paditur që ti sjell fëmijët në Qendër për Punë Sociale, e njëjta nuk është përgjigjur thirrjes së Qendrës dhe nga zyrtarja e rastit ka kërkuar që përmes parashtrësës të e njofton lidhur me veprimet që i ka ndërmarrë Qendra për Punë Sociale. Të gjitha veprimet që i ka ndërmarrë në këtë lëndë janë në përputhje me afatet ligjore, dhe se mos pranimi i palës në zyre për kontakt, kjo është e vërtetë dhe se nuk e ka ndërmend të e pranon dhe për këtë fakt nëna e të paditurës e ka telefonuar numrin personal, nuk e din ka e ka marrë numrin, duke e kërcënuar me pretendimin që ai duhet ti besojë fëmijët vajzës së tij, këtu të paditurës dhe për këtë e ka njoftuar Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren. Dhe në fund ka sqaruar se konflikt interesi nuk ka pasur me asnjë nga palët, përkundrazi palët dhe të autorizuarit e tyre nuk kanë pasur asnjë kundërshtim në gjykimin e lëndës, nga ana e tij. Është në pritje të përgjigjes nga Qendra për Punë Sociale, mirëpo me palën e paditur Qendra për Punë Sociale, kanë vështirësi pasi që asnjëra nuk i përgjigjet thirrjes së Qendrës për dëgjimin e fëmijëve.

U.D. Kryetari i Gjykatës pas hetimit paraprak, shikimit në shkresat e lëndës C.nr..... , analizimit të kërkesës së parashtruesit të ankesës, deklaratën e gjyqtarit, konstaton se ankesa është e pa bazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet si e pa bazuar.

U.D. Kryetari i gjykatës fillimisht konstaton se çështja civilo-juridike C.nr....., ( e cila është kthyer në rigjykim me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr..... të datës 24.05.2021) në punë është ndarë gjyqtarit A.B., në të cilën parashtruesja e ankesës është në cilësi të palës së paditur. Parashtruesja në pretendimet e saj në ankesës pretendon se gjyqtari i çështjes nuk ka pranuar ta takojë edhe përkundër faktit se ka qenë disa herë në Gjykatë, kjo lëndë i ka shkaktuar lodhje nga pritjet e tepërta dhe zvarritjen e procedurave si dhe lodhje psikike që po i shkaktohet nga vonesat e kësaj lënde. Sipas vlerësimit të U.D. Kryetarit të gjykatës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara, pasi që në rastin konkret komunikim me palë ex-parte, pa praninë e palës tjetër në këtë rast paditësit apo përfaqësuesit të autorizuar, është komunikim i pahijshëm dhe i palejuar. Gjyqtari i rastit ka vepruar drejt dhe në përputhje me ligjin me rastin e mos pranimit të palës së paditur në komunikim ex partë, pasi që kjo do të shkaktonte shkelje të kodit të etikës dhe humbja e besimit të palëve në procedurë dhe publikut në kuptim të asaj që vendimi i gjyqtarit të bëhet në bazë të komunikimit privat me gjyqtarin, e jo të merret vendimi ashtu siç duhet në bazë të meritave të rastit. Në këtë drejtim, sjellja e tillë e gjyqtarit e cila në rastin konkret është konform dispozitave ligjore, në asnjë mënyrë nuk e vë në dyshim paanshmërinë e tij në këtë çështje juridike apo konfliktin e interesit ashtu siç pretendon pala në ankesë, pasi që shihet

qartë se gjyqtari i çështje menjëherë pas kthimit të çështjes në rigjykim nga Gjykata e Apelit, në afatin ligjor ka trajtuar këtë çështje as Ligjit të Procedurës Kontestimore, duke i respektuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqëse në procedurë, ndërsa vonesat që janë shkaktuar kanë qenë për shkak të mos dëgjimit të fëmijëve në Qendrën për Punë Sociale, pikërisht për shkak se pala e paditur nuk i është duke përgjigjur thirrjeve të Qendrës. Si përfundim, U.D. i Kryetarit të gjykatës, konsideron se ankesa e parashtrueses ndaj gjyqtarit A.B., duhet të refuzohet si e pa bazuar, pasi që nuk ka mundur të gjejë se ka bërë shkelje të detyrave apo sjelljeve të gjyqtarit.

Andaj, siç u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 9 par.6 lidhur me nenin 17 par.5 të ligjit nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**ADGJTHP.nr.3/2022 më datë 28.03.2022**

**B. Profesional**  
**Arlind Sharani**

U.D. Kryetari i Gjykatës  
Artan Sejrani



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa